



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 313/1 Prot.

Tiranë, më 19. 04. 2018

V E N D I M

Nr. 108, Datë 19. 04. 2018

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 32, datë 28.02.2018, e bërë nga T. Gj., kundër Kompanisë së Pastrimit të qytetit të Beratit “Infinit Construction”, në të cilën pretendon diskriminim *për shkak të racës*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

T. Gj. sqaron se, ka qënë punonjëse pranë Kompanisë së Pastrimit të qytetit të Beratit “Infinit Construction”. Sipas saj, në të gjithë periudhën që ka punuar pranë këtij subjekti, nuk i është dhënë asnjë masë disiplinore apo vlerësim negativ. Që prej muajit Nëntor 2017, pretendon se është larguar nga puna në mënyrë të padrejtë. Në këto kushte, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se ankuesja nuk kishte vënë në dispozicion të Komisionerit informacion të mjaftueshëm për të vijuar me shqyrtimin e ankesës, lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe diskriminues nga ana e Kompanisë së Pastrimit të qytetit të Beratit “Infinit Construction”. Duke qënë se në formularin e ankesës ishte lënë vetëm kontakti¹ i përfaqësuesit të komunitetit rom/egjiptian të qytetit të Beratit, shtetasit B. D., atëherë Komisioneri nëpërmjet telefonit i kërkoi² atij informacione shtesë lidhur me shqyrtimin e ankesës. Gjithashtu, në datat 06.03.2018 dhe 13.04.2018, me anë të email-it u kontaktua sërish shtetasi B. D., por nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë informacion rreth ankesës së shtetasës T. Gj.

¹ Nr. i telefonit të përfaqësuesit të Komunitetit rom/egjiptian në qytetin e Beratit, shtetasit B. D.

² Më datë 12.04.2018, të vërë në dispozicion të KMD-së kontaktet e ankueses, informacion lidhur me periudhën që ka punuar pranë Kompanisë “Infinit Construction” dhe informacion rreth arsyes së largimit nga puna.

Në këto kushte, pas analizimit të ankesës nr. 32, datë 28.02.2018, Komisioneri konstatoi se:

Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 33, pika 4/ç të tij, parashikon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*.

Konkretisht, mungesa e sqarimit se si mund të kontaktohet ankuesja dhe informacionit paraprak lidhur me shjegovin e situatës diskriminuese të kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bën që nga ana formale dhe përmbajtja ankesa të jetë e pa plotësuar.

Përsa më lart, duke analizuar në tërësi ankesën nr. 32, datë 28.02.2018, të T. Gj., Komisioneri gjykon se, në rastin konkret ankesa bie ndesh me kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, e në këto kushte në mungesë të informacionit të mjaftueshëm ajo nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 12, 20, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç) të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 32, datë 28.02.2018, e T. Gj., pasi ankesa nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Raca)
(Fusha: Punësim)